



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 10.03.2025
Numër Protokolli: 1694/2025

A.nr.162/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani,-kryetar, Ardita Haxhnikaj– Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.162/2025, të datës 21.01.2025 të parashtruar nga ankuesja A.C, kundër organit të punësimit: Zyra e Kryeministrit në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.03.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.162/2025, e datës 21.01.2025 e parashtruar nga ankuesja A.C.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi i datës 20.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Zyrës së Kryeministrit lidhur me pozitën „Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”.

A r s y e t i m

Ankuesja A.C (me tej referuar vetëm ankuesja), me datën 18.01.2024, përmes emalit zyrtar të Këshillit ka parashtruar ankesës e cila ankesë është pranuar më datë 21.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.162/2025, kundër njoftimit të datës 20.12.2024, lidhur me refuzimin e aplikacionit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit për pozitën „Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, në Zyrën e Kryeministrit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 23.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Zyra e Kryeministrit , ndërsa kjo e fundit, më datë 04.02.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr. 162/2025 të datës 21.01.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për A.C; Vërtetim i dates 26.02.2024, për A.C, i lëshuar nga Menaxherja e Personelit e Komunës së Mitrovicës Veriore; Pasqyra e trustit për A.C, për periudhën nga data 05.01.2009, deri me datën 05.12.2024; Konkursi me numër referencë RN00015657, i dates 05.11.2024; Vërtetim i dates 17.01.2025; Njoftimi i datës 20.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit; e- mali i dates 21.01.2025, dërguar nga A.C, për KPMSHCK; e- mali i dates 18.01.2025, dërguar nga A.C, për KPMSHCK; Kërkesë për përgjigje në ankesë e dates 23.01.2025, dërguar nga R.K, për N.X; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 162/2025, e dates 04.02.2025; Konkursi me numër referencë RN00015657, i dates 05.11.2024; Diplomë e dates 10.08.2013, për A.C; Certifikatë e vitit 2021, për A.C; Vendimi Ref; 216/2656, i dates 12.06.2023, për A.C, I lëshuar nga Kryesuesja e Këshillit Shtetëror për Njohje e Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Certifikatë e muajit nëntor të vitit 2023, për A.C; Certifikatë e vitit 2021, për A.C; Diplomë për A.C, e lëshuar nga Malmo University; Vendim me numër protokollit 07-020/04-0050979, i dates 25.06.2024, i lëshuar nga Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Mitrovicës Jugore; Vërtetim me numër protokollit 43/2023, i dates 29.03.2023, për A.C; Vërtetim me numër protokollit 01-102/02-002116/24, i dates 23.02.2024, i lëshuar Shefja e Personelit e Komunës së Mitrovicës Veriore; Shkresë e lëshuar nga DANISH -REFUGEE CONNCCI, për A.C; Shkrese e lëshuar nga BQK, për A.C; Shkresee e dates 15.03.2023, për A.C, e lëshuar nga ohio University; Dehsmi e lëshuar nga Kolegji për A.C; Shkresë e dates 17.11.2022, për A.C, e lëshuar nga Bordi Drejtues i Universitetit të Ohajos; Certifikatë e dates 19.09.2012, për A.C, e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës; Certifikatë e dates 09.05.2010, për A.C; Certifikatë e datës 08.10.2021, për A.C; Certifikatë e datës 02.06.2023, për A.C; Deklaratë me shkrim e A.C; E- mali i datës 13.12.2024, nga B.J, për N.X; raporti i verifikimit i datës 07.03.2023; - emali i datës 07.03.2024, nga Ch, për N.X; Regjistrimi i Aplikacioneve; Konkursi me numër referencë RN00013181, i datës 26.01.2024; Vërtetim për ankesë; Raporti i dates 20.12.2024, për verifikim paraprak sipas Konkursi për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komenteve”; Lista e Aplikantëve; Njoftimi i dates 20.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Zyrës së Kryeministrit; Konkursi me numër referencë RN00015567, i datës 05.11.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Zyra e Kryeministrit më datë 05.11.2024 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00015657 për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve” numri i kërkuar një (1) pozitë, Drejtues i Mesme me afat aplikimi nga data 06.11.2024 deri me datë 05.12.2024.

Tutje, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Zyrës së Kryeministrit, me datë 20.12.2024, ka publikuar njoftimin pemës të cilit njoftimi përfundon procedura e konkursit “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, me arsyetimin se pasi ka përfunduar procedura e verifikimit për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në këtë procedurë, është konstatuar së asnjeri nga kandidatet nuk i ka plotësuar kriteret ligjorë sipas konkursit për përfshijë në listën e ngushtë dhe për këtë arsye kjo procedure e pranimit përfundon pa kandidat fitues.

Ankuesja A.C, e pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 21.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 20.12.2024, lidhur me refuzimin e aplikacionit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit për pozitën „Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, me pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon së kam të përfunduar Bachelor në Ekonomi dhe Statistikë, në Universitetin Amerikan në Kosovë dhe master në zhvillimin Ndërkombëtar, dhe dëshmitë e trustit si dhe kontratat e mëparshme në sistemin e SIMBNJ, duke përfshirë përvojat e mija si themeluese dhe menaxhere në Edukation Innovators Kosova, si drejtoresh Ekzekutive, Danish Refugge, Këshilli danez për Refugjatë, Këshilli konsultativ për Komunitete si zëvendës kryesuese nga viti 2018, deri

në vitin 2020, në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe përvojën e punës për pozitën ‘‘Drejtoresh në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, në Komunën e Mitrovicës, duke pretenduar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të vlerësojë kërkesën dhe ti rivlerësoj arsyet e refuzimit të aplikacionit.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN0015657 për pozitën ‘‘Drejtor i Zyrës për Çështjet e Komuniteteve’’, në Zyrën e Kryeministrit, numri i kërkuar një (1) pozitë, Drejtues i Mesëm, si kuotë e rezervuar apo mase afirmative vetëm për komunitetet jo shumicë dhe për pasojë konstatoi se si kriteret të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Juridik, Ekonomik, Administratë Publike, shkenca Politike, Sociologji, Filozofi.

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njëën nga kërkesat në vijim:

tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

dy (2) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

një (1) vit përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: ‘‘Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njëën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji. 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës. 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimin të përcaktuara në këtë ligj’’, ndërsa lidhur me kërkesën për bashkëngjitjen e dokumentacioneve, sipas nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: ‘‘2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion. 3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, kopja e dëshmisë se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore dhe dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje, dorëzohen gjatë fazës së verifikimit para emërimit. 4. Kandidatët e plotësojnë aplikacionin në pajtim me Ligjin përkatës për Përdorimin e Gjuhëve’’.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me shpalljen e konkursit për pozitën përkatëse, si kuotë e rezervuar apo mase afirmative vetëm për komunitete jo shumicë, iu referuar Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik respektivisht nenit 10, i cili përcakton se : ‘‘Në institucionet publike qendrore, minimum dhjetë për qind (10%) e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga

pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.”, si dhe nenit 13 paragrafi 1, 2 dhe 4 i Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: “1. Kuota e rezervuar për komunitetet jo shumicë, në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore është së paku dhjetë për qind (10%). 2. Institucionet e administratës qendrore sipas paragrafit 1. të këtij neni, përfshijnë Institucionet e Administratës Shtetërore, Institucionet e Pavarura dhe Agjencitë e Pavarura 4. Institucionet publike me qëllim të plotësimit të kuotës si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nën përfaqësuar.”.

Nga raporti i datës 20.12.2024, për verifikim paraprak lidhur me konkursin me numër të referencës RN00015657, për pozitën ”Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, dërguar nga Udhëheqja e Divizionit të Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit, tek Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, është konstatuar së për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve”, kanë aplikuar njëzet e tre (23), kandidatë dhe se pas përfundimit të konkursit, Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit, brenda afatit ligjore ka bërë verifikim paraprak, nëse kandidatët për pranimit në shërbimin civil i plotësojnë kushtet e përgjithshme apo të veçanta sipas shpalljes së konkursit dhe në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dëshmime të kërkuara, dhe se bazuar në kërkesën e Euo/EUSR, që të jenë pjesë në monitorimin e procesit të rekrutimit, sipas konkursit për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështjet e Komuniteteve”, në Zyrën e Kryeministrit, janë ftuar në monitorimin e procesit në rastin konkret verifikimin paraprak e që kryhet nga NJMBNJ, dhe në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit me datën 17.12.2024, duke filluar nga ora 09:30, në zyrën 406, kati i IV, ndërtesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe se në takim ishte prezent edhe përfaqësuesja e EUO/EUSR znj, A.S, dhe se përfaqësuesen znj, A.S, e njoftova së konkursi është i paraparë vetëm për komunitete jo shumicë dhe se për disa dilema rreth kualifikimeve - drejtimeve arsimore të aplikueseve, kemi marr përgjigje nga Agjencia për Akreditim dhe se u shqyrtuan dokumentacioni i njëzet e tre (23) kandidatëve të Komunitetit jo shumicë shtatë (7), të komunitetit jo shumicë të deklaruar shqiptar, andaj bazuar në kriteret e konkursit është konfirmuar së asnjëri nga kandidatet nuk i ka plotësuar kushtet sipas konkursit në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe nuk mund të vazhdon procedura tutje.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë në kontekst të vlerësimit të përputhshmërisë me dispozitat ligjore në fuqi, ka analizuar edhe dosjen e ankueses dhe ka konstatuar se ankuesja në rastin e aplikimit për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështjet e Komuniteteve”, në Zyrën e Kryeministrit, ka dorëzuar Diplomën e dates 10.08.2013, të lëshuar nga Instituti Recster, dhe ka përfunduar Bachelor i Shkencave të Aplikuara”, drejtimi Artet dhe Shkencat e Aplikuara, Diplomën të lëshuar nga Univerziteti OHIU, ku ka përfunduar Master i Arteve, si dhe vendimin me numër protokollit Ref; 216/2656, të dates 12.06.2023, të lëshuar nga Kryesuesja e Këshillit Shtetëror për Njohje e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, ku përmes këtij vendimi i njihet grada Master i Arteve -Studime për Zhvillim Ndërkombëtar, ndërsa dëshmi për përvojën e punës ka ofruar vërtetimin me numër protokollit 43/2023, të datës 29.03.2023, të lëshuar nga SHFMU “Bedri Gjinai”, në Mitrovicë, me c’ka dëshmohet së nga data 01.07.2017, deri me datën 29.03.2023, ka mbajtur pozitën,, Mësimdhënëse e lëndës së Matematikës, tek paralelet Boshnjake, si dhe vendimin me numër protokollit 01-01-102/02-02-0002116/2024, të datës 23.02.2024, të lëshuar nga Shefja e Personelit e Komunës së Mitrovicës së Veriut me c’ka dëshmohet së nga data 23.05.2023, ka mbajtur pozitën “Drejtoresh e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport”, andaj pas analizimit të dokumentacionit të ankueses kolegji i këshillit konstaton se ankuesja nuk i ka plotësuar kushtet e përgjithshme për tu përfshirë në listën e ngushtë.

Bazuar në Konstatimet si me lartë Kolegji i Këshillit, konstaton së Zyra e Kryeministrit, në rastin e anulimit të konkursit për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk i ka plotësuar kushtet ka vepruar në

pajtim me dispozitat 44, paragrafi 1 neni 5, nen paragrafi 5.1, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, ku përcaktohet se; *1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit, si dhe nenin 4, paragrafi 1, neni 5, paragrafi 5.1, të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se; 1. Pranimi në shërbimin civil, sipas kësaj rregulloreje, behët për të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur, publike, në përputhje me parimet e përcaktuara në LZP. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit, ndërlidhur me nenin 7, paragrafi 1,2,3 dhe 4, të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku shprehimisht thuhet se; 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve, sepse në bazë raportit të dates 20.12.2024, dërguar nga Udhëheqja e Divizionit të Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit, tek Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, del pas verifikimit paraprak si dhe gjithë dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar nuk i plotësojnë kushtet e konkursit, kandidatët që kanë aplikuar lidhur me konkursin me numër të referencës RN00015657, për pozitën "Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve".*

Kolegji i Këshillit, i ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se për pozitën " Drejtor i Zyrës për Çështjet e Komuniteteve", në Zyrën e Kryeministrit, ka pasur parregullsi në fazën e verifikimit paraprak dhe se i kam plotësuar kushtet se kam dorëzuar dëshmi për përvojën e punës dhe së në bazë të dëshmimeve të dorëzuar unë kam plotësuar kushtet e konkursit për tu përzgjedhur në pozitën pasi që ka analizuar dokumentacionin e ankueses Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja nuk i pa plotësuar kushtet e konkursit, andaj mbi bazën e kësaj Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Divizioni i Burimeve Njerëzore i Zyrës së Kryeministrit, me rastin e publikimit të njoftimit të datës 20.12.2024 përmes të cilit bëhet i ditur fakti se procedura e rekrutimit për pozitën "Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve", pasi ka përfunduar procedura e verifikimit për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në procedurë është konstatuar së asnjeri nga kandidatët nuk i ka plotësuar kushtet për t'u përfshirë në listën e ngushtë, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje

Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 162/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses A.C;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*